

Projekti mbesin në buxhet, jo në lumenj

■ FAQE



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NGRIHEN DYSHIME SE SPECIALJA PO I PËRDORË SHKOLLAT NË KOSOVË PËR FUSHATË KUNDËR UÇK-së DHE KRERËVE TË SAJ

FAQE 4-5

OPINION

SHTETARËT NË KOSOVË DHE GJYKATA E KOSOVËS NË HAGË

Nga Prof.
dr. Kudus LAMA,
gjeneral në pension



AKTUALE



TRUMPI IA ANULON KANADASË FTESËN PËR T'IU BASHKUAR BORDIT TË PAQES **F. 2**

SHBA I JEP KOSOVËS SKANER PËR KONTROLLE KUFITARE NË VLERË PREJ 3 MILIONË DOLLARËSH F. 6

EDITA TAHIRI: QYTETARËT JANË LODHUR ME KËTË AMULLI, KOSOVA DUHET TË DALË NË PROCESE TË ZHVILLIMIT F. 7

EKONOMI



BIE NUMRI I PËRFITUESVE TË PENSIONEVE INVALIDORE TË PUNËS

ODA AMERIKANE DHE DOGANA MBAJNË TRYEZË TË PËRBASHKËT PËR FUQIZIMIN E BASHKËPUNIMIT

PROKURORIA NË PRIZREN: 109 TË NDALUAR PËR MANIPULIM TË VOTAVE **F.3**



KOSOVA DHE SERBIA PAJTOHEN PËR KOMISIONIN PËR PERSONAT E ZHDUKUR **F. 3**



RENOVA

Maqedoni PUTZ Tet +389 44 487 300; +389 44 487 009
Xhepçisht -Tetovë +389 44 487 755
Gurëz-Ferizaj Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk Mbr: +377 44 501 289



**NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE**

**INFO: 049-111-101,
044-511-177**
www.princesha-ks.com



Buniamini
FABRIKA E LLAOEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIĆ



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878



SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net / www.sigma-ks.net



INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

TRUMPI IA ANULON KANADASË FTESËN PËR T’IU BASHKUAR BORDIT TË PAQES

UASHINGTON, 23 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ia ka tërhequr Kanadasë ftesën për t’iu bashkuar nismës së tij, Bordi i Paqes, e cila synon zgjidhjen e konflikteve botërore. Ky vendim i Trumpit erdhi pas fjalimit të kryeministrit të Kanadasë, Mark Carney, në Forumin Ekonomik Botëror në Davos, ku ai i kritikoi hapur shtetet e fuqishme, duke thënë se ato i përdorin integrimin ekonomik si armë dhe tarifatat si mjet trysnie. “Ju lutem, le të shërbejë kjo letër për të njoftuar se Bordi i Paqes po e tërheq ftesën për ju në lidhje me anëtarësimin e Kanadasë në atë që do të jetë bordi më prestigjioz i udhëheqësve të mbledhur”, shkroi Trump në një postim në Truth Social drejtuar Carneyt.

Javën e kaluar zyra e Carneyt kishte njoftuar se ai ishte ftuar të shërbente në bord dhe se synonte ta pranonte ftesën. Carney mori duartrokitje të rralla në Davos pas fjalimit që mbajti, në të cilin u bëri thirrje kombeve ta pranonin fundin e një rendi global të bazuar në rregulla. Kanadaja, e cila së fundmi ka nënshkruar një marrëveshje tregtare me Kinën, mund të tregojë se si “fuqitë e mesme” mund të veprojnë së bashku për ta shmangur viktimizimin nga hegjemonia amerikane, shtoi ai. Trumpi u kundërpërgjigj duke thënë se Kanadaja “jeton falë Shteteve të Bashkuara” dhe u tha pjesëmarrësve në Davos se Carney duhet të jetë mirënjohës për bujarinë që ShBA-ja ka treguar deri tani. “Mbaje mend këtë, Mark, herën tjetër që bën deklaratat

e tua”, shtoi ai, duke iu drejtuar direkt Carneyt. Tërheqja e ftesës për Kanadanë erdhi disa orë pasi Trumpi zyrtarisht e themeloi bordin, i cili fillimisht ishte menduar të konsolidonte një armëpushim në Gazë. Anëtarëve të përhershëm u kërkohet ta ndihmojnë financimin e bordit me një pagesë prej 1 miliard dollarësh secili, sipas Trumpit. “Pasi ky bord të formohet plotësisht, ne mund të bëjmë praktikisht çfarë të duam”, tha Trumpi të enjten në Zvicër. “Dhe do ta bëjmë këtë në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara”. Krijimi i bordit u miratua nga një rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së si pjesë e planit të Trumpit për paqe në Gazë, dhe zëdhënësi i OKB-së, Rolando Gomez, tha të enjten se angazhimi i OKB-së në bord do të jetë vetëm në këtë



kontekst. Vendet anëtare përfshijnë Kosovën, Shqipërinë, Argentinën, Bahrejin, Marokun, Pakistanin dhe

Turqinë. Aleatë të tjerë të ShBA-së, si Britania, Franca dhe Italia, kanë thënë se nuk do t’i bashkohen bordit tani për tani.

SHBA-JA EDHE ZYRTARISHT LARGOHET NGA ORGANIZATA BOTËRORE E SHËNDETËSISË

Uashington, 23 janar - Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë përfunduar zyrtarisht procesin e tërheqjes nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO), duke i dhënë fund marrëdhënies shumëvjeçare me institucionin më të rëndësishëm global të shëndetit publik. Vendimi u konfirmua nga Departamenti Amerikan i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Humanitare dhe përmbush një premtim të hershëm të presidentit amerikan Donald Trump, i cili e kishte nisur



procesin e largimit që gjatë mandatit të tij të parë. Tërheqja u

përsheptua në ditën e parë të mandatit të dytë përmes një urdhri ekzekutiv, shkruan CNN. Sipas ligjit amerikan, ShBA-ja ishte e detyruar ta njoftonte institucionin një vjet përpara largimit dhe t’i shlyente detyrimet financiare ndaj organizatës. Megjithatë, autoritetet amerikane pranojnë se vendi ende i detyrohet WHO-s rreth 260 milionë dollarë, fonde që, sipas ekspertëve ligjorë, ka pak gjasa të paguhet. Administrata amerikane ka njoftuar se të gjitha fondet për

WHO janë pezulluar, ndërsa punonjësit dhe kontraktorët amerikanë të lidhur me organizatën janë tërhequr. ShBA nuk do të marrë më pjesë në komitetet dhe strukturat teknike të drejtuara nga WHO. Pavarësisht kësaj, zyrtarët amerikanë theksojnë se vendi do ta vazhdojë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e shëndetësisë përmes marrëveshjeve dypalëshe dhe organizatave joqeveritare, veçanërisht në fushën e parandalimit dhe monitorimit të

sëmundjeve infektive. Vendimi ka shkaktuar reagime të forta në komunitetin ndërkombëtar të shëndetit publik. Ekspertë të shumtë paralajmërojnë se largimi i ShBA-së nga WHO mund ta dobësojë bashkëpunimin global dhe ta bëjë botën më të cenueshme ndaj pandemive të ardhshme. Me këtë veprim, ShBA bëhet vendi i parë dhe i vetëm që largohet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë e cila aktualisht numëron 193 shtete anëtare.

RRITET NUMRI I VIKTIMAVE NGA PËRPLASJA E DY TRENAVE NË SPANJË

Madrid, 23 janar - Numri i viktimave nga përplasia mes dy trenave të shpejtë në Spanjë ka arritur në 45, pasi trupat e dy burrave të tjerë u gjetën në një vagon të dëmtuar, tha Qeveria rajonale e Andaluzisë më 22 janar. Besohet se trupat u përkasin dy personave që figuronin si të zhdukur pas aksidentit, që ndodhi të dielën në mbrëmje. Identifikimi formal nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Kordobës ende nuk është kryer. Trupat u gjetën në një vagon që kishte rënë rreth katër metra poshtë hekurudhës dhe që kishte pësuar dëme të mëdha. Numri i të plagosurve nga aksidenti është 123, nga të cilët 31 vazhdojnë të jenë të shtruar në spital. Gjashtë persona ndodhen



ende në kujdes intensiv, njoftuan shërbimet e emergjencës së Andaluzisë në X. Megjithatë, sipas tyre, asnjëri nga të plagosurit nuk është në rrezik për jetën. Sipas Gardës Civile, në mesin e viktimave kishte tri shtetase të

huaja, të gjitha gra: një nga Gjermania, një nga Rusia dhe një nga Maroku. Kryetari i rajonit të Andaluzisë, Juanma Moreno, tha se nuk ka më persona të zhdukur dhe se kërkimet për viktimat janë

ndërprerë. Identifikimi i viktimave ka qenë i vështirë, prandaj autoritetet u kanë bërë thirrje familjeve që dyshojnë se mund të kenë humbur të afërm të ofrojnë mostra të ADN-së. Dyzet e tre trupa të viktimave veçse janë identifikuar, por identiteti i tyre nuk është bërë publik. Shkaku i aksidentit, që është një nga më të rëndët në historinë e Spanjës, ende nuk dihet. Autoritetet nuk e kanë përjashtuar mundësinë që shkaku të jetë dëmtimi i hekurudhës ose ndonjë defekt në njërin nga trenat. Vetëm dy ditë pas aksidentit të së dielës, një shofer treni vdiq pasi u aksidentua me një tren lokal në

Gelida, në perëndim të Barcelonës. Dhjetëra pasagjerë u lënduan, pesë prej tyre rëndë. Një tjetër aksident hekurudhor ndodhi të enjten, kur një tren i vogël lokal u përplas me një kran në Murci, në lindje të Spanjës dhe sipas autoriteteve gjashtë persona pësuan lëndime të lehta. Sindikata e shoferëve të trenave në Spanjë ka shpallur një grevë kombëtare treditore duke nisur nga 9 shkurti, për t’i mbështetur kërkesat për më shumë siguri dhe besueshmëri në rrjetin hekurudhor. Spanja ka rrjetin më të madh në Evropë për trenat e shpejtë me mbi 3 mijë kilometra hekurudhë që lidhin qytetet e mëdha përfshirë Madridin, Barcelonën, Seviljan, Valencian dhe Malagën.

KOSOVA DHE SERBIA PAJTOHEN PËR KOMISIONIN PËR PERSONAT E ZHDUKUR

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 JANAR - Kosova dhe Serbia janë pajtuar ta funksionalizojnë komisionin e përbashkët për personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, pas raundit të dialogut me Serbinë të zhvilluar në Bruksel, tha se tani mbetet që javët e ardhshme të takohen “zëvendësit tanë dhe të përcaktojnë prioritetet e para për punën e komisionit të përbashkët”. “Qëllimi ishte që të arrijmë dakordim që sot ta funksionalizojmë komisionin e përbashkët për jetësimin apo zbatimin e Marrëveshjes për personat e pagjetur në mes të kryeministrit [të Kosovës, Albin] Kurti dhe presidentit [të Serbisë, Aleksandar] Vuçiq. Takimet ishin të suksesshme dhe në fund arritëm që përfundimisht ta jetësojmë këtë objektiv”, tha Bislimi.

Ndërkaq kryenegociatori i Serbisë, Petar Petkoviç, e cilësoi raundin e dialogut të 22 janarit si “takimin e parë të komisionit të përbashkët për zbatimin e Deklaratës për personat e zhdukur”. “Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe domethënëse dhe shpresoj që pas këtij takimi të parë të përshpejtohen të gjitha proceset në drejtim të gjetjes së të gjithë personave të zhdukur”, tha Petkoviç.

Kryenegociatori i Kosovës dhe ai i Serbisë njëherësh janë edhe bashkëkryesues të këtij

komisioni. Ndërkaq kryetari i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur, Andin Hoti, i cili ishte i pranishëm në Bruksel, tha se për tre vjet Serbia kishte refuzuar themelimin e këtij komisioni. “Ne mirëpresim takimin e radhës, me pritjen e qartë që pala serbe të vijë me hapa konkretë dhe të matshëm, në përputhje me obligimet e marra në Deklaratën e personave të zhdukur”, shkroi Hoti në “Facebook”.

Marrëveshja u arrit pas disa orë bisedimesh që ndërmjetësi evropian në dialog, Peter Sorensen, zhvilloi veç e veç me Bislimin dhe Petkoviçin. Në fund të këtyre takimeve, në orët e mbrëmjes u mbajt një takim i përbashkët, në të cilin marrëveshja u formalizua. Ky komision i përbashkët për personat e pagjetur është pjesë e Deklaratës së përbashkët për personat e zhdukur, për të cilën u pajtuan kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, më 2023. Palët u pajtuan për zbatimin e plotë të deklaratës së përbashkët për personat e zhdukur gjatë një takimi trepalësh mes kryenegociatorëve në dhjetor 2024 në Bruksel.

Për çështjen e themelimit të komisionit për personat e zhdukur, palët kishin diskutuar edhe gjatë një raundi bisedimesh më 11 shtator të vitit 2025. Megjithatë, ai raund bisedimesh kishte përfunduar pa asnjë rezultat.

Në luftën e zhvilluar në Kosovë më 1998-’99 janë vrarë mbi 13 000

civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Afër 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur - pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

Raundi i ri i dialogut u zhvillua pas vizitës së Sorensenit në Prishtinë dhe Beograd javën e kaluar.

Takimi i 22 janarit ishte i pari në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës këtë vit.

Gjatë vizitës së tij në Prishtinë më 14 janar, Sorenseni tha se lidhur me dialogun “kam shpresa se viti 2026 do të na japë atë që viti 2025 nuk na e dha”. “Çfarë do të bëjmë ne është të sigurohemi që palët të ulen dhe të bisedojnë. Duhet ta gjejmë një mënyrë që kjo të ndodhë”, theksoi Sorenseni në Prishtinë. Ai tha se do të punojë për të gjetur një mënyrë që dy vendet fqinje të zhvillojnë bisedime të nivelit të lartë në përpjekje për t’i normalizuar marrëdhëniet.

Kosova dhe Serbia nuk kanë zhvilluar takim të nivelit të lartë që nga viti 2023, pas rritjes së tensioneve mes tyre për shkak të një sulmi nga një grup serbësh të armatosur ndaj Policisë së Kosovës në veriun e banuar me shumicë serbe në shtator të atij viti.

Kurti, i cili pritet të jenë në krye të qeverisë së vendit edhe për një mandat të tretë katërvjeçar - e ka kushtëzuar vazhdimin e dialogut me dorëzimin e të dyshuarit për sulmin në Banjskë të Zveçanit që la një rreshter të vrarë, Millan Radoiçiq.

Radoiçiqi ishte nënkryetar i Listës

Serbe, partisë më të madhe të serbëve të Kosovës, kur ndodhi sulmi dhe e mori përgjegjësinë për të. Beogradi nuk ka pranuar t’ia dorëzojë Kosovës atë dhe thuhet se ai endet i lirë në Serbi.

Edhe Serbia ka kushtet e veta në dialog, siç ritheksoi edhe Petkoviç pas takimit me Sorensenin më 16 janar në Beograd.

Kryenegociatori serb tha se përparimi në dialogun e ndërmjetësuar nga blloku varet nga gatishmëria e Kosovës për ta themeluar një asociacion të komunave me shumë serbe.

Kosova dhe Serbia veçse arritën marrëveshje për rrugën drejt normalizimit, e njohur si Marrëveshja e Ohrit, më 2023, por nuk janë duke e zbatuar atë.

Ndër pikat e marrëveshjes është edhe themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, por Prishtina nuk ka ndërmarrë hapa për ta përbushur këtë kërkesë.

Sorenseni: BE-ja pret nga komisioni i përbashkët ta sqarojë fatin e personave të zhdukur

Peter Sorensen, i dërguari evropian për dialogun, ka thënë se Bashkimi Evropian (BE) ka pritshmëri të mëdha nga një komision i përbashkët mes Kosovës dhe Serbisë për ta sqaruar fatin e personave të zhdukur gjatë luftës së viteve 1998-’99 në Kosovë.

Sorenseni konfirmoi në një

komunikatë të premten se Kosova dhe Serbia e zhvilluan takimin e parë trepalësh të komisionit të përbashkët për personat e zhdukur të enjten në Bruksel.

“Bashkimi Evropian ka pritshmëri të mëdha që Komisioni i Përbashkët të japë një kontribut të rëndësishëm në sqarimin e fatit të personave të zhdukur dhe në ndihmën për mbylljen e një kapitulli të dhimbshëm për familjet, të cilat kanë pritur tepër gjatë për përgjigje”, tha ai.

Ai sqaroi se palët kishin arritur pajtueshmëri për themelimin e këtij komisioni në dhjetor të vitit 2024.

Komisioni buron nga Deklarata e përbashkët për personat e zhdukur, për të cilën kishin arritur marrëveshje Kosova dhe Serbia më 2023 në Bruksel si pjesë e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve.

Sorenseni tha të premten se qëllimi i komisionit të përbashkët është ta mbikëqyrë zbatimin e kësaj deklaratë, “e cila synon të kontribuojë në zbardhjen e fatit të personave ende të zhdukur, përfshirë personat e zhdukur me forcë, të ofrojë mbyllje për familjet e tyre dhe të nxisë pajtim dhe paqe të qëndrueshme”.

Sorenseni zhvilloi bisedime të gjata veç e veç me kryenegociatorin e Kosovës, Besnik Bislimin, si dhe atë të Serbisë, Petar Petkoviç, të enjten në Bruksel.

Në fund të atyre takimeve, në orët e mbrëmjes ai e mbajti takimin e parë trepalësh të komisionit të përbashkët.



NGRIHEN DYSHIME SE SPECIALJA PO I PËRDORË SHKOLLAT NË KOSOVË PËR FUSHATË KUNDËR UÇK-së DHE KRERËVE TË SAJ

SBASHK-u, OVLUÇK-ja, KMDLNj dhe komuna e Prishtinës kanë kundërshtuar ligjëratën e Gjykatës Speciale në Gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë. Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka shprehur shqetësim se ligjëratat që lidhen me Gjykatën Speciale nëpër shkolla në Kosovë mund të jenë përpjekje për të ndikuar në opinionin publik dhe të nxënësit kundër UÇK-së dhe ish-krerëve të saj që po gjykohen në Hagë

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 23 JANAR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) ka reaguar lidhur me ligjëratën e mbajtur në Gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë nga përfaqësues të Gjykatës Speciale dhe organizatës Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (YIHR). Siç thuhet në reagim, SBASHK-u ka shprehur shqetësimin e thellë dhe kundërshtimin e fuqishëm ndaj mbajtjes së kësaj ligjërata në Gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë.

SBASHK-u e konsideron të papranueshme që institucionet arsimore të shfrytëzohen për promovimin e një narrative të njëanshme, me synimin që nxënësit të binden se Gjykata Speciale përfaqëson drejtësi. “Nuk ka padrejtësi më të madhe sesa fakti që për më shumë se pesë vjet mbahen në paraburgim luftëtarët e lirisë, bashkëpunëtorë të NATO-s, të cilët luftuan për të drejtat elementare të popullit të Kosovës - për lirinë, dinjitetin dhe të drejtën për arsimim. Është e pamohueshme që gjatë viteve të represionit serb, Serbia kishte mbyllur të gjitha shkollat shqipe

në Kosovë, përfshirë edhe Gjimnazin ‘Xhevdet Doda’. Pikërisht në atë periudhë të errët mësimdhënësit dhe punëtorët e arsimit, të organizuar edhe përmes SBASHK-ut, mbajtën gjallë arsimin shqip me sakrificat të jashtëzakonshme. Prandaj, është paradoksale, e padrejtë dhe moralisht e papranueshme që sot, në po ato ambiente shkollore, të promovohet një gjykatë që po gjykon njëanshëm luftën çlirimtare të popullit të Kosovës, duke e barazuar viktimën me agresorin”, thuhet në reagimin e kësaj sindikate. SBASHK-u ka reaguar edhe ndaj përfshirjes së organizatës Nisma

e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (YIHR), e cila përmes këtij aktiviteti ka kontribuar në futjen e një agjende politike dhe ideologjike në institucionet arsimore, pa respektuar ndjeshmërinë historike, kombëtare dhe arsimore të shoqërisë sonë. “U bëjmë thirrje organeve përgjegjëse - Ministrisë së Arsimit, Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prishtinë dhe menaxhmentit të Gjimnazit ‘Xhevdet Doda’ - që të marrin masa konkrete lidhur me këtë rast dhe të mos lejojnë që shkollat të shndërrohen në hapësira për promovimin e mekanizmave që cenojnë të vërtetën historike dhe dinjitetin e luftës sonë çlirimtare”, është thënë në reagim. Njëkohësisht, SBASHK-u apelon te të gjithë anëtarët tanë, punëtorët e arsimit në Kosovë, që të tregojnë vigjilencë dhe përgjegjësi profesionale e kombëtare, duke mos lejuar organizimin e aktiviteteve të tilla në institucionet tona arsimore.

“Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës riafirmon qëndrimin e saj të palëkundur në mbrojtje të vlerave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe në përkrahje të drejtuesve institucionalë të asaj lufte - Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi - të cilët po mbahen padrejtësisht në Hagë, vetëm pse ishin në anën e drejtë të historisë. Liria e Kosovës nuk është krim. Lufta për arsim, liri dhe dinjitet nuk gjykohe”, thuhet në reagimin e SBASHK-ut. Dhomat e Specializuara të Kosovës (KSC) kanë konfirmuar për “Telegrafi”-n se zhvillojnë aktivitete informuese në Kosovë që nga viti 2018 si pjesë e Programit të Shtrirjes së Informacionit, duke përfshirë nxënës, komunitetin lokal, gazetarë dhe avokatë. Zëdhënësja Angela Griep tha se këto takime diskutojnë mbi mandatin dhe procedurat e gjykatës, duke ofruar informacion publik të ngjashëm

me atë që gjendet në faqen zyrtare të KSC-së.

OVLUÇK-ja ngre dyshime që Specialja po përdor shkollat për fushatë kundër UÇK-së dhe ish-krerëve në Hagë


Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka shprehur shqetësim se ligjëratat që lidhen me Gjykatën Speciale nëpër shkolla në Kosovë mund të jenë përpjekje për të ndikuar opinionin publik dhe nxënësit kundër UÇK-së dhe ish-krerëve të saj që po gjykohen në Hagë, duke paralajmëruar se këto veprime mund të shërbejnë si “fushatë” për krijimin e një terreni kundërshtues ndaj luftës çlirimtare.

Kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, ka thënë për “Ekonomia Online” se është i befashuar nga zhvillimet dhe se, sipas tij, një veprim i tillë është i papranueshëm. “Na ka ardhur befasi, singërisht nuk e kemi pritur që do të ndodhë që një gjykatë e cila është e njëanshme, shkon dhe bën fushatë nëpër shkolla. Kjo ka ndodhur për herë të parë. Unë nuk kam dëgjuar më herët. Unë nuk e di se si drejtori i shkollës i ka pranuar ata përfaqësues të asaj gjykate që kanë shkuar dhe kanë bërë fushatë në shkolla. Ne nuk e dimë a kanë bërë fushatë anti-UÇK apo fushatë kundër UÇK-së dhe kundër pjesëtarëve të UÇK-së dhe kundër atyre që janë në Hagë, presidentit dhe të tjerët. Apo janë duke përgatitur një terren që ta bindin opinionin, ku tash kanë filluar të shkojnë edhe te fëmijët dhe nëpër shkolla që dëshirojnë t’i bindin edhe fëmijët për t’i kthyer kundër UÇK-së”, ka thënë ai.

Gucati u bëri thirrje shkollave të mos pranojnë aktivitete të tilla dhe kërkoi që autoritetet komunale të marrin masa ndaj drejtuesve të institucioneve arsimore që, sipas tij, kanë lejuar këto ligjërata.

KMDLNj: Specialja ligjëron për... gjykim politik!

Edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar për këtë ligjëratë. “Gjykata Speciale Raciste, e ndryshkur nga mungesa e integritetit moral dhe profesional, në kushte gjysëmilegale mbajti një ligjëratë për nxënësit e gjimnazit ‘Xhevdet Doda’ në Prishtinë në përpjekje për ta përmirësuar imazhin e rrënuar duke shkelur në mënyrë flagrante të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës që po mbahen si pengje në burgun e Hagës. Pas kësaj ‘ligjërate’, pati shumë kundërshtime dhe vetëm pas kësaj filluan distancimet ndonëse dikush duhet të mbajë përgjegjësi. Dihet organizatori, një OJQ që ka gjetur një kohë të papërshtatshme për këtë organizim. Është koha kur po përmbyllet procesi politik kundër UÇK-së dhe luftës çlirimtare, që po zgjatë më shumë se 5 vite, në rrethana të një terri informativ, mungesë të transparencës dhe llogaridhënies, shkeljes brutale të drejtave të njeriut përmes



Nxënësi kërkon lirimin e Thaçit: “Free Hashim Thaçi”

Pas kësaj ligjërate në fletën dorëzuar nxënësve, kërkohet vlerësimi i ligjëratës. Pyetjet janë të tipit nëse ngjarja ishte e organizuar mirë, nëse kishte mjaftueshëm informata për Gjykatën Speciale, nëse informacionet kanë qenë të kuptueshme dhe pyetje të ngjashme. Në një prej këtyre vlerësimeve, nxënësit kanë shprehur pakënaqësi lidhur me përgjigjet që kanë marrë. Në fund, te komentet, një prej nxënësve ka kërkuar lirimin e Hashim Thaçit. “Free Hashim Thaçi”, ka shkruar ai.

mohimit të një gjykimi të drejtë, fer, të pavarur, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht apo nga grupet e interesit. Një gjykatë që për qëllim e ka rishkrimin e historisë, kriminalizimin e luftës çlirimtare dhe ridizajnimin e skenës politike, jo që nuk duhet lejuar të mbajë ‘ligjërata’ por është dashur të refuzohet dhe pamundësohet ta përhapë tregimin e Serbisë për luftën në Kosovë. Një gjykatë që nuk monitorohet (nuk lejon të monitorohet) nga askush dhe që shkelë të gjitha protokollet dhe procedurat nuk mund të ligjërojë për procedura dhe të drejtat e njeriut. Një gjykatë që qenka pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës e që me asgjë nuk identifikohet me Kosovën nuk duhet të lejohet të shpërndajë

gënjeshtra të Serbisë në Kosovë”, thuhet në reagimin e KMDLNj-së. Sipas KMDLNj-së, Gjykata Speciale Raciste ka krijuar një narracion fajësues ndaj krerëve të UÇK-së që po gjykohen në një proces krejtësisht të padrejtë ende pa e marrë një vendim gjë që nuk e ka bërë asnjë gjykatë më parë. “Nuk pati asnjë reagim institucional për faktin se janë në një linjë me Gjykatën Speciale përmes dërgimit të dosjeve akuzuese, dëshmitarëve të mbrojtur dhe pakësimit të mbrojtjes duke ua shkurtuar përkrahjen materiale. KMDLNj e gjykon këtë manipulim dhe keqpërdorim të nxënësve nga Gjykata Speciale Raciste dhe organizatori sepse po e përdorin

si arsyetim për veprimtari kriminale dhe kundër të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria , të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Rama për ligjëratën e Speciales në shkolla: Isha shumë i indinjuar, s’ka pasur as leje as koordinim

Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka reaguar lidhur me mbajtjen e një ligjërate të Gjykatës Speciale në Gjimnazin “Xhevdet Dodaj” pa, siç tha ai, leje apo koordinim me institucionet komunale, duke u

shprehur i indinjuar. Ai ka paralajmëruar masa ndaj përgjegjësve. “Unë kur mora vesh isha shumë i indinjuar për arsye se nuk ka pasur as leje as koordinim me askënd, as prej drejtorisë as prej kabinetit tim. Kemi ndërmarrë masa të menjëhershme. Pra kush ka bërë një gjë të tillë pa marrë leje, pa koordinim normal që do të ketë edhe veprime të ndryshme. Jam tejet i indinjuar me atë çka kanë bërë. Nuk duhet me ndodh kurrë ajo në institucionet tona, në qytet e askund tjetër pa një leje prej Drejtorisë së Arsimit. Ato do të jenë të ndërlidhura me rregulloret në fuqi. Do të ndërmarrim masa”, ka thënë kryetari i Prishtinës, Përparim Rama.

SHBA I JEP KOSOVËS SKANER PËR KONTROLLE KUFITARE NË VLERË PREJ 3 MILIONË DOLLARËSH

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 JANAR - Shtetet e Bashkuara i kanë dhuruar Kosovës një skaner mobil, të llojit Rapiscan, që është vendosur në pikëkalimin kufitar në Merdar - që lidh Kosovën me Serbinë.

Kjo teknologji e prodhuar në Shtetet e Bashkuara, në vlerë prej tre milionë dollarësh, sipas Ambasadës Amerikane në Prishtinë, do t'i ndihmojë autoritetet e Kosovës që ta luftojnë kontrabandën e mallrave.

ShBA-ja tha se, përveç luftimit të kontrabandës së mallrave, skaneri i ri do ta ulë kohën e pritjes, duke lehtësuar qarkullimin ndërkufitar.

Ky donacion është pjesë e një marrëveshjeje më të gjerë mes ShBA-së, Gjermanisë dhe Kosovës, “që sjell përfitime konkrete për Kosovën, përfshirë aftësinë e saj për ta përfaqësuar veten në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, një arritje që e festuam së bashku mbi një vit më parë”, tha e ngarkuara me punë në Ambasadën Amerikane, Anu Prattipati. “Është një shembull tjetër i partneritetit të fortë mes ShBA-së dhe institucioneve të Kosovës, përfshirë doganat dhe policinë kufitare”, tha Prattipati. Sipas saj, këto dy institucione janë kyçe për sigurinë e kufijve të Kosovës dhe luftimit të kontrabandës.

Në ceremoninë inauguruese të këtij skaneri, ministri në detyrë i

Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, tha se ky skaner do ta rrisë aftësinë e Kosovës për të parandaluar, zbuluar dhe menaxhuar në mënyrë efektive kërcënimet ndërkufitare.

“Siguria e kufirit përbën një shtyllë themelore të sigurisë kombëtare dhe funksionimit të plotë të shtetit ligjor. Në një kontekst të ndryshimeve të mëdha globale dhe të rritjes së rreziqeve të sigurisë, ndërtimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të reja kufitare janë të domosdoshme për garantimin e stabilitetit dhe forcimin e aftësisë së institucioneve tona për t'u përballur me sfidat bashkëkohore”, tha Sveçla. Sipas tij, investimet në teknologjinë moderne, infrastrukturë dhe burime njerëzore janë elementë

kyçë për menaxhimin kufitar.

“Në këtë drejtim jam shumë i lumtur që në pikën kufitare në Merdar po inaugurojmë skanerin Rapiscan, i cili vjen si donacion nga ShBA-ja. Ky donacion përfaqëson jo vetëm një avancim të rëndësishëm teknologjik, por edhe një dëshmi konkrete të partneritetit të fuqishëm dhe të qëndrueshëm në mes të Kosovës dhe ShBA-së”, theksoi ai.

Ndërkaq, drejtori i Doganave të Kosovës, Agon Llugaliu, tha se vendi do t'i sigurojë edhe dy skanerë të tjerë përmes fondeve të Bankës Botërore.


Skaneri i ri që u vendos në Merdar është pjesë e një angazhimi të përbashkët të Gjermanisë dhe ShBA-së me

Kosovën për sigurinë kufitare.

Më 2023, duke e akuzuar Serbinë se po shkelte Marrëveshjen për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Kosova kishte ndaluar importin e mallrave nga fqinji verior.

Një vit më vonë, kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, kishte deklaruar se këto dy shtete, së bashku me Bashkimin Evropian i kishin premtuar Kosovës sigurimin e skanerëve. Po atë vit u hoq masa e ndalesës për mallra serbe, dhe Kurti tha se kur do të vinin skanerët, puna e kontrolleve kufitare do të lehtësohej.

Atëbotë autoritetet në Kosovë deklaruan se në pikat kufitare do të vendoseshin skanerë të teknologjisë tredimensionale (3D).



PROKURORIA NË PRIZREN: 109 TË NDALUAR PËR MANIPULIM TË VOTAVE

PRIZREN, 23 JANAR - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Petrit Kryeziu, ka bërë me dije të premten se 109 persona janë ndaluar për 48 orë nën dyshimet për keqpërdorim të votave të zgjedhjeve të parakohshme të 28 dhjetorit.

Autoritetet kanë thënë se të ndaluarit janë komisionarë dhe në mesin e tyre ka edhe familjarë të kandidatëve për deputetë.

Në një konferencë për medie, Kryeziu ka thënë se i gjithë manipulimi ka ndodhur në Qendrën Komunale të Numërimit dhe janë prekur votat e kandidatëve për deputetë. Sipas tij, një manipulim i tillë nuk ka mundur të ndodhë pa një kompromis mes komisionarëve



të katër partive më të mëdha politike. “Po flasim për komunën e Prizrenit që janë shtuar hiç më pak se 40 497 vota dhe janë hequr hiç më pak se 27 520 vota. Pra, diferenca totale e keqpërdorimeve është 68 017 vota”, ka thënë Kryeziu. Ai ka thënë se vetëm një vendvotim,

apo një klasë, ka dalë që nuk i ka pasur votat e keqpërdorura, teksa numri i votave të falsifikuara për një kandidat ka arritur në mbi 6 000.

Ky aksion vjen pas dyshimeve se ka pasur manipulime të mëdha me vota, veçanërisht brenda subjekteve politike, në

zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit.

Kjo madje e ka detyruar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ta nisë rinumërimin e plotë të votave i cili është duke vazhduar tash e disa ditë.

Në fillim të muajit komisioni gjeti mospërputhje në votat për kandidatët për deputetë pas një hetimi fillestar dhe më pas zbuloi gjatë rinumërimit të pjesshëm se dallimet në vota ishin të mëdha. Si pasojë, prokurorët filluan të mbledhnin të dhëna lidhur me dyshimet për manipulime të mundshme me vota, ndërsa komisioni e shkarkoi përfaqësuesit politikë në komisionin e vet komunal në Prizren.

Në Kosovë manipulimi i votave është vepër penale e dënueshme me burgim.

Megjithatë, së voni organizata joqeveritare ÇOHU ka publikuar një hulumtim që tregoi se mbi 90 për qind e rasteve për manipulime zgjedhore përfundojnë me dënime me kusht ose gjoba. Shumica e kandidatëve për deputetë të cilëve u janë hequr më së shumti vota gjatë rinumërimit, e kanë mohuar të kenë pasur gisht në keqpërdorim dhe kanë thënë se e dënojnë këtë dukuri. Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit në detyrë Albin Kurti i ka fituar zgjedhjet e 28 dhjetorit me mbi 51 për qind të votave. Ajo pritet të ketë 57 ulëse në legjislaturën e dhjetë dhe ta formojë qeverinë e re, por shkuarja në rinumërim, i cili nuk pritet të ketë ndikim te votat e partive, mund ta zvarritë procesin.

PROJEKTET MBESIN NË BUXHET, JO NË LUMENJ

Përmbytjet në Kosovë përsëriten pothuajse çdo vit, ndërsa shumë projekte për rregullimin e lumenjve dhe ndërtimin e digave mbeten të parealizuara pavarësisht se parashihen në buxhete. Ekspertët vlerësojnë se problemi nuk lidhet vetëm me reshjet, por me keqmenaxhimin e lumenjve, ndërhyrjet e pakontrolluara dhe mungesën e masave parandaluese afatgjate

PRISHTINË, 23 JANAR - Pavarësisht prej hartave të rrezikut, planeve shumëvjeçare dhe dhjetëra miliona eurove të planifikuara, në terren ndryshimi mbetet i kufizuar. Sa herë që reshjet e shiut shtohen, Kosova përballet me të njëjtin skenar: lumenjtë dalin nga shtrati, rrugët bllokohen, shtëpitë përmyten, bizneset pësojnë dëme dhe tokat bujqësore shkatërrohen. Buxhetet parashikojnë projekte për rregullimin e lumenjve dhe ndërtimin e digave, por shumë prej tyre mbeten të parealizuara, duke bërë që cikli i përmytjeve të përsëritet. Në fillim të këtij viti disa komuna u përfshinë nga vërshimet. Fushë-Kosova, Malisheva, Rahoveci, Klina, Mitrovica e Jugut, Vushtrria, Drenasi, Skenderaj, Gjakova dhe Lipjani ishin ndër zonat më të prekura. Të njëjtat komuna përjetuan përmytje edhe në vitet 2021 dhe 2023 - dëmet në të cilat, në vlerë prej miliona eurosh, vazhdojnë të kompensohen.

Ekspertët: Nuk është vetëm natyra, është keqmenaxhimi

Skender Bublaku, ekspert i ujërave dhe profesor në një kolegji privat në Kosovë, thotë se një nga problemet kryesore mbetet mosmenaxhimi i lumenjve në nivel vendi. Sipas tij, vërshimet nuk mund të parandalohen plotësisht, por mund dhe duhet të minimizohen. “Kur problemet përsëriten çdo vit, kjo nuk ka të bëjë me fatkeqësi natyrore, por me dështim të paralajmërimit

dhe mungesë të masave parandaluese”, thotë Bublaku për Radion Evropa e Lirë. Ai thekson se identifikimi i zonave të rrezikut nuk mjafton, nëse nuk shoqërohet me trajtim të lumenjve në tërësi, e jo vetëm në segmente të izoluar. “Sikur mjetet që shkojnë çdo vit për kompensimin e dëmeve të orientoreshin drejt rregullimit të lumenjve, brenda 10 vjetësh do të kishim vërshime të minimizuara”, shton ai. Shtretërit e shumë lumenjve në Kosovë janë shkatërruar nga nxjerrja e zhavorrit.

Institucionet, nga reagimi emergjent në menaxhim rreziku

Ushtruesi i detyrës së ministrit të Infrastrukturës, Hysen Durmishi, thotë për Radion Evropa e Lirë se institucionet kanë kaluar tashmë nga reagimi emergjent në menaxhim të rrezikut. Sipas tij, janë identifikuar gjithsej 398 zona me rrezik nga përmytjet në nivel vendi - prej tyre 108 zona me rrezik ekstrem, 95 me rrezik shumë të lartë dhe 195 me rrezik të lartë. Këto zona përfshijnë rreth 341 mijë banorë, mbi 58 mijë



familje, 32 objekte kulturore, 57 zona të mbrojtura dhe 538 zona me rëndësi ekonomike. Po ashtu, rreth 491 kilometra lumenj konsiderohen segmente të ekspozuara ndaj përmytjeve të shpeshta dhe tashmë janë analizuar në mënyrë të detajuar, sipas Durmisht. Pavarësisht kësaj, në terren pasojat vazhdojnë të përsëriten.

Shumë plane, pak zbatim

Sipas raportit “Mjediti i Evropës 2025”, i publikuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjeditit e Kosovës, përmytjet e vitit 2023 shkaktuan dëme prej 3.75 milionë eurosh vetëm në familje. Në buxhetin e vitit 2025 u parapanë dhjetëra projekte mjedisore, kryesisht për ndërtimin e urave dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve. Projekte të ngjashme u planifikuan edhe me buxhetin e këtij viti, i cili ende nuk është miratuar, me synim uljen e rrezikut nga vërshimet deri në

60 për qind. Radio Evropa e Lirë analizoi disa prej projekteve të planifikuara vitin e kaluar dhe të publikuara në Informatorin për Qytetarët për Buxhetin e Vitit 2025. Aty parashihen investime prej dhjetëra miliona eurosh për ndërtim digash, rregullim të shtretërve të lumenjve dhe zhvillim të sistemit të ujërave të zeza - me afatin e përfundimeve prej tre vjetësh. Ministria e Mjeditit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nuk iu përgjigj pyetjeve të Radios Evropa e Lirë se sa prej këtyre projekteve kanë nisur realisht dhe sa kanë përfunduar. Raporti financiar nëntëmujor (janar-shtator 2025) i Ministrisë së Financave tregon se disa nga to nuk kanë filluar fare, ndërsa disa të tjera janë në proces të realizimit. Sipas këtij dokumenti, 83 për qind progres ka projekti për rregullimin e shtratit të lumit në Shtime, ndërsa vetëm 12 për qind projekti për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë. Kryetari i Kaçanikut, Sabedin Vishi, konfirmon për Radion Evropa e Lirë se ndërtimi i shtratit të lumit Nerodime në këtë komunë nuk ka nisur, ndonëse në vitin 2025 ishin paraparë 1.5 milion euro. Përgjegjësia, sipas tij, bie tek autoritetet qendrore. “Ky projekt është i rëndësishëm, sepse kalon nëpër qytetin e

Kaçanikut dhe vazhdon drejt Ferizajt. Në rast të reshjeve të dendura, do t'i parandalonte vërshimet”, thotë Vishi. Edhe kryetari i Podujevës, Shpejtim Bulliqi, thotë se projekti për lumin Llap nuk ka nisur ende, por thekson se ndërhyrjet e viteve të fundit - pastrimi, thellimi dhe ndërtimi i mureve mbrojtëse - kanë ndihmuar në shmangien e përmytjeve të fundit. “Këto masa kanë dhënë rezultate”, sipas tij.

Teknologjia nuk mjafton

Megjithëse institucionet flasin për rrjete moderne monitorimi: 23 stacione meteorologjike, 36 stacione reshjesh, 34 hidrometrike dhe dhjetëra pika monitorimi të ujërave nëntokësore - të ngritura në pesë vjetët e fundit sipas Durmishit, ekspertët paralajmërojnë se teknologjia nuk e zëvendëson veprimin në terren. Bublaku vlerëson se Kosova është seriozisht e rrezikuar nga vërshimet, veçanërisht gjatë muajve të dimrit. “Strukturat ekzistuese të lumenjve duhet të rishikohen. Ato nuk i plotësojnë kriteret. Ura nuk guxon të përmytet - ky është problem shumë serioz”, thotë ai. Gjatë vërshimeve të fundit, në komunën e Lipjanit u përmytën dy ura - një tregues ky i seriozitetit të situatës në terren në kushtet kur projektet nuk realizohen.

Edita Tahiri: Qytetarët janë lodhur me këtë amulli, Kosova duhet të dalë në procese të zhvillimit

PRISHTINË, 23 JANAR - Ish-zëvendëskryeministria Edita Tahiri ka vlerësuar se Kosova ndodhet në amulli. Ajo ka bërë me dije se vitin e kaluar Kosova e mbylli duke vendnumëruar, kurse vitin 2026 e hapi duke numëruar

votat. Në profilin e saj në “Facebook”, ajo ka shkruar se Kosova duhet të dalë në procese të zhvillimit e përparimit. “Nga vendnumërimi në numërim. Kosova e kaloi

vitin e kaluar duke vendnumëruar hyri në këtë vit të ri duke rinumëruar votat - Kosova duhet të dalë në procese të zhvillimit e përparimit. Janë lodhur qytetarët me këtë amulli”, ka shkruar Tahiri.



Bie numri i përfituesve të pensioneve invalidore të punës

PRISHTINË, 23 JANAR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e mirëqenies sociale për muajin dhjetor 2025. Në muajin dhjetor 2025, krahasuar me muajin dhjetor 2024, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-27,5 %); skema për pensionet e Trepçës

(-20,6 %); skema për pensionet familjare (-10,6 %); skema e ndihmës sociale (-10,3 %); skema e pensioneve kontribut-paguesve të moshës (-2 %); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,4 %). Në muajin dhjetor 2025, krahasuar me muajin dhjetor 2024, kishte rritje të numrit të

përfituesve nga: skema për Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike (12,6 %); skema e pensioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (8,6 %); skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (8 %); skema e pensioneve bazike të moshës (7,5 %); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që

punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5,1 %); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (4,5 %); skema për veteranët e luftës (2,7 %). skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (0,8 %); dhe skema e kompensimeve për personat e verbër (1,2 %).



ODA AMERIKANE DHE DOGANA MBAJNË TRYEZË TË PËRBASHKËT PËR FUQIZIMIN E BASHKËPUNIMIT

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 JANAR - Oda Amerikane ka pritur në një takim me anëtarët e saj drejtorin e përgjithshëm të Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, për të diskutuar përkritazi me planin e punës të Doganës për vitin 2026 si dhe fuqizimin e bashkëpunimit. Në hapje të diskutimit, drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, vlerësoi pozitivisht partneritetin ndërmjet dy institucioneve si dhe lavdëroi reformat e vazhdueshme të ndërmarrë nga Dogana e Kosovës përgjatë viteve, duke e dalluar këtë institucion në

mesin e organizatave homologe në Ballkan. Drejtori i përgjithshëm i Doganës, Agron Llugaliu, foli për synimet e vazhdueshme të institucionit të cilin ai e drejton për lehtësimin e tregtisë dhe mbështetjen e sektorit privat për realizimin e objektivave të tij brenda kornizës ligjore. Ai tha se të gjithë treguesit e performancës për vitin 2025 janë më të mirë krahasuar me vitet paraprake, duke theksuar përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që reflektohet edhe me rritjen e numrit të zyrtarëve doganorë. Duke folur për lehtësimin e tregtisë, Llugaliu foli për inaugurimin e një skaneri të ri në vendkalimin kufitar në



Merdar si donacion i Shteteve të Bashkuara të Amerikës si dhe skanerëve të tjerë që pritet të futen në funksion përgjatë vitit. Ai theksoi zgjerimin e vendkalimit doganor në

Vërmicë, si një ndër projektet më të rëndësishme infrastrukturore, duke pasur parasysh që vëllimi më i madh i shkëmbimeve tregtare përpunohet përmes këtij vendkalimi kufitar.

Duke folur për zbatimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zero tarifa për mallrat me origjinë amerikane, drejtori i Doganës tha se po analizohen praktikatat më të mira ndërkombëtare për përcaktimin e origjinës, e ndihmë në këtë aspekt e jep edhe Programi për Zhvillimin e të Drejtës Komerciale, i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (CLDP). Gjatë takimit u diskutuan edhe çështjet specifike me të cilat ndërmarrjet private ballafaqohen e për të cilat u premtua zgjidhje brenda kuadrit ligjor, duke u theksuar njëkohësisht edhe rëndësia e dialogut të sinqertë publiko-privat.

BORDI I PAQES PËR GAZËN, AKB-ja: SHBA-ja VENDOSI STANDARDET NDËRKOMBËTARE, BE-ja HESHT!



PRISHTINË, 23 JANAR - Krijimi i Bordit të Paqes për Gazën nga administrata amerikane nën drejtimin e Donald Trumpit nuk është thjesht iniciativë humanitare. Ky bord koordinon rindërtimin e Gazës pas shkatërrimeve totale nga lufta, duke vendosur ShBA-në si aktor kryesor në vendimmarrjen globale. Kështu ka vlerësuar kryetar i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini. Ai ka thënë se ndryshe nga pritshmëritë, shumica e vendeve të BE-së nuk morën pjesë, përveç Bullgarisë dhe

Hungarisë. “Heshtja evropiane tregon mungesë vizioni dhe gatishmërie për të kontribuar në rindërtimin dhe stabilitetin rajonal, duke lënë hapësirë që ShBA të vendosë standardet dhe ritmin e ri. Një element kyç është pjesëmarrja e Kinës dhe Rusisë, që tregon ndikimin e ShBA-së edhe mbi rivalët globalë. Trumpi po vepron si një udhëheqës strategjik global, duke koordinuar procesin e rindërtimit dhe vendosjen e standardeve ndërkombëtare. Edhe Kosova dhe Shqipëria janë angazhuar në këtë bord, edhe

pse të kufizuar financiarisht, rritur peshën diplomatike dhe duke marrë një rol aktiv në vendim marrjet ndërkombëtare”, ka thënë Shahini, duke shtuar se mesazhi është i qartë. “Bordi i Paqes nuk është vetëm humanitar. Ai është një mjet politik dhe gjeostrategjik që fuqizon ShBA-në dhe tregon se politika, diplomacia dhe strategjia janë të pandashme. Heshtja e BE-së është e dukshme, ndërsa ShBA po krijon rendin e ri botëror”, ka theksuar Agim Shahini, kryetar i AKB-së.

BDI-ja: Politikat tatimore të qeverisë po rrjepin qytetarët dhe po krijojnë pasiguri juridike

SHKUP, 13 JANAR - Bashkimi Demokratik për Integrim shpreh shqetësim të thellë për politikën e padrejta dhe represive tatimore të qeverisë aktuale të cilat po godasin drejtpërdrejt qytetarët tanë, veçanërisht ata që kanë punuar jashtë vendit në kushte të rënda dhe të rrezikshme. Sipas BDI-së, protestat para Drejtorisë së të Ardhurave Publike janë dëshmi e qartë e dështimit institucional dhe e një politike tatimore të verbër, që përmes

tatimeve retroaktive po u vendos barrë të padrejtë financiare qytetarëve që për vite me radhë kanë siguruar ekzistencën e familjeve të tyre dhe kanë kontribuar në ekonominë e vendit. “Është e papranueshme që qytetarë që kanë punuar në misionet ndërkombëtare në Irak, Afganistan, si dhe në vendet e tjera, shpesh duke rrezikuar jetën, sot të trajtohen si objekt për mbushjen e arkës shtetërore. Edhe më skandaloze

është mosnjohja e statusit të jorezidentit tatimor, pavarësisht dëshmi të qarta ligjore dhe faktit se shumica e tyre kanë qëndruar mbi 183 ditë jashtë vendit. Kjo qeveri, përmes DAP-it, po krijon pasiguri juridike, po injoron ligjin dhe po e shndërron tatimin në mjet ndëshkimi. Qytetarët nuk janë kundër tatimeve, por janë kundër grabitjes, padrejtësisë dhe vendimeve retroaktive që cenojnë dinjitetin dhe sigurinë

e tyre ekonomike”, është thënë në reagimin e BDI-së. BDI-ja kërkon pezullim të menjëhershëm të vendimeve tatimore me efekt retroaktiv; njohje të plotë të dokumentacionit për statusin e jorezidentit dhe transparencë dhe qartësi institucionale. “Qeveria duhet të ndalë politikën që rrjepin qytetarët dhe ta kuptojë se shteti nuk ndërtohet duke ndëshkuar ata që kanë sakrifikuar. BDI-ja do të vazhdojë të jetë zëri i qytetarëve



dhe të kundërshtojë çdo politikë që cenon drejtësinë sociale dhe dinjitetin njerëzor”, thuhet në reagimin e BDI-së.

SHTETARËT NË KOSOVË DHE GJYKATA E KOSOVËS NË HAGË



Nga Prof. Dr. **Kudusi LAMA**, gjeneral në pension

Kam dëgjuar të thuhet se në Gjykatën e Kosovës në Hagë nuk ka asnjë simbol të shtetit të Kosovës. As flamuri shtetëror nuk është i vendosur në asnjë vend.

Dhe po pyes: a është normale në akt i tillë? Unë ndoshta jam pa njohuri, por e di se shtetarët e Kosovës kanë njohuri të plota për dukuri të tilla dhe për atë se si duhet vepruar në situata të tilla. Dhe në radhën e shtetarëve të Kosovës rreshtohen Presidenti, Qeveria, Parlamenti dhe gjithë aparati rreth tyre, ashtu sikurse sistemi i drejtësisë dhe media. Mendoj që të gjithë këto përbëhen nga njerëz të arsyeshëm, të shkolluar, atdhetar, kombëtarisht të formuar, me ndjenjë përgjegjësie për detyrën, me besnikëri ndaj ligjit, me dëshirë për të bërë më të mirën për qytetarët e Kosovës, për të ardhmen e atdheut dhe kombit.

Këtu përjashtoj ndonjërin që akoma i shërben pronarit të vjetër – Serbisë, i veshur me petkun e shtetarit të Kosovës, duke fshehur fytyrën e vërtetë,

(që ndjej hidhërim të thellë nëse do të ketë ndonjë të tillë), por që ashtu si infeksionet të cilat pastrohen nga trupi i njeriut me mjeshtërinë e specialistëve të mjekësisë edhe ata do të pastrohen me punën e inspektorëve të historisë. Megjithëse kam shkruar disa herë për figurën e jashtëligjshme të Gjykatës së Kosovës në Hagë, për mënyrën si po e trajton ecurinë e jetës së atyre burrave të çlirimit të Kosovës që janë marrë peng në atë gjykatë. Por po ndalem edhe njëherë për të bërë një vështrim mbi këta dy përbërës të kohës tonë, që kanë përgjegjësi për ecurinë normale të drejtësisë ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Luftës së saj të lavdishme. E këta janë: Shtetarët në Kosovë dhe Gjykata e Kosovës në Hagë, që mendoj se ka ardhur koha e fundit, të jenë të nderuar ose me turp përpara historisë së nesërme të Kosovës dhe jo thjeshtë personalisht si individë, por si shtet dhe gjykatë drejtësie.

Pse kam këtë mendim: Sepse Gjykata e Kosovës në Hagë është si mall pa të zot. Ajo Gjykatë burrat tanë të luftës Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin, po vijon të na i mbajë peng, pa dhënë asnjë shenjë drejtësie, pa shikuar asnjë standard të drejtësisë ndërkombëtare, duke ua ndaluar fjalën dhe duke u privuar të drejtat. Ndërsa në

Prishtinë bëhet sikur qeveriset. Shtetarët i thonë popullit se po qeverisin mirë. Por një qeverisje e mirë puna e parë mbron shtetasit e vet edhe kur janë qytetarë të thjeshtë. Ndërsa në kushtet kur të kërcënuar pa asnjë arsye janë prijësit e Luftës Çlirimtare të Kosovës, nuk mund të qeveriset asnjë ditë pa u bërë palë me ta. Sepse pas tyre qëndron historia e Kosovës, pas tyre qëndron liria e Kosovës, pas tyre qëndron shteti i Kosovës, pas tyre qëndron pastërtia e Kosovës, pas tyre qëndron e ardhmja e Kosovës. Pra rënia e tyre sjellë rënien e të gjitha këtyre vlerave jetësore të kombit shqiptar, sepse ishin prijësit e asaj që i realizoj të gjitha këto, - Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Unë nuk u them shtetarëve mos i thoni popullit që Kosovën e kemi çliruar ne. Unë nuk them mos u thoni qytetarëve të Kosovës që këtë shtet të Kosovës e kemi krijuar ne, unë nuk them mos u thoni qytetarëve të Kosovës që liria është e sigurt vetëm me ne, unë nuk them mos u thoni qytetarëve të Kosovës se e ardhmja mund të ndërtohet vetëm nën udhëheqjen tuaj. Sepse po nuk thatë kështu nuk mund të qëndroni në pushtet. Prandaj politikisht ashtu veproni, sepse pa e mashtruar nuk mund ta qeverisësh një popull siç duket, megjithëse unë kam pasur tjetër mendim. Por në ndërgjegjen tuaj, duhet të jeni të qartë, se ishin të tjerë ata që e çliruan Kosovën, ishin

të tjerë ata që e krijuan shtetin e Kosovës, ishin të tjerë ata që vërtetë kishin kapacitete ta bënin lirinë të sigurt në çdo kohë, ishin të tjerë ata që i hodhën themelet e të ardhmes së Kosovës. E duke pasur ndërgjegjen të kthjelltë për këto, mendoj se duhet të kryeni detyrën ndaj prijësve të luftës që na janë marrë peng me hile. Sepse kështu vërtetë mund të bëheni të lavdishëm. Dhe duke kryer këtë detyrë ju nuk u shërbeni thjeshtë atyre prijësve të luftës. por mbroni Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës; mbroni Luftën Çlirimtare të Kosovës; mbroni pastërtinë e krijimit të shtetit të Kosovës; mbroni lirinë e Kosovës; mbroni nderin e kombit shqiptar; në fund të fundit mbroni edhe dinjitetin e atij shteti të cilin po e udhëhiqni.

Dhe dua të them, se ka disa nga ne – luftëtarët, që e hedhim edhe ndonjë fjalë më tepër. Themi nganjëherë edhe ndonjë fjali apo bëjmë edhe ndonjë akuzë të papranueshme. Por ju shtetarët nuk jeni individë. Ju jeni bërthama e qenies së shtetit të Kosovës. Nuk mendoj se duhet të bëheni kaq të vegjël sa të merreni me deklarata individësh. Në karrierën time kam ecur sipas parimit: Komandanti shikon jo çfarë shikohet, por çfarë atij i intereson të shikojë dhe dëgjon jo çfarë dëgjohej, por çfarë atij i intereson të dëgjojë. Sepse të dashur shtetarë, po dëgjuat çfarë dëgjohej e shikuat çfarë

shikohet, do të mbeten duke shikuar e dëgjuar dhe nuk mund të bëni asnjë punë tjetër. Dhe ju duhet të dëgjoni e shikoni vetëm çfarë duket e thuhet që i prish punë Kosovës. Asgjë tjetër për shtetarët nuk ndodhë as nuk thuhet.

E kryesore për Ju shtetarët e Kosovës sot është ajo çfarë shikohet e dëgjohej në Hagë. Atje ku kemi peng prijësit e Luftës që na dha Kosovën, të cilën po e qeverisni ju sot.

Dhe mendoj se forca juaj është pikërisht të qëndrimi përballë kësaj padrejtësie që është instaluar në Hagë prej pesë vitesh. Nga marrja nën kontroll ose përballja me këtë institucion që megjithëse i krijuar nga ju shtetarët e Kosovës, sot ka rebeluar dhe nuk dëshiron t'u njohë por bën si donë Beogradi. Këtu është forca ose dobësia juaj, këtu është autoriteti i shtetit të Kosovës, këtu është bindja se Kosova ka të ardhme, këtu është edhe drejtësia dhe e drejta hyjnore e ligjore. Sepse përballë keni një gjykatë e cila është kthyer në një instrument mesjetar inkuizicioni. Të paktën me çfarë është parë dhe dëgjuar deri tani. E unë uroj të jem i pasaktë dhe në përfundim të dal i zhgënjyer. Sepse kam shumë dëshirë t'i besoj drejtësisë ndërkombëtare dhe kombëtare e shtetërore. E për mua dhe për të gjithë shqiptarët mendoj, sot pasqyra e drejtësisë ndërkombëtare është Gjykata e Kosovës në Hagë.

KOSOVA NUK KA NEVOJË PËR EDUKIM QË PRODHON VETËFAJËSIM KOLEKTIV DHE DELEGJITIMON LUFTËN ÇLIRIMTARE



Shkruan: Arsim **BAJRAMI**

Organizimi i ligjëratave nga e ashtuquajtura Gjykatë Speciale në Shkollën e Mesme “Xhevdet Doda” në Prishtinë përbën një akt të rëndë politik, institucional dhe moral, i cili nuk mund dhe nuk duhet të kalojë pa reagim të

fuqishëm publik.

Ky veprim nuk është i rastësishëm dhe as neutral. Ai përbën pjesë të një strategjie të vazhdueshme për normalizimin e një mekanizmi gjyqësor politik, i cili që nga themelimi i tij ka pasur për qëllim komprometimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe relativizimin e luftës çlirimtare të popullit të Kosovës.

Drejtoria e Arsimit në Prishtinë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) bartin përgjegjësi të drejtpërdrejtë politike dhe institucionale për

lejimin e këtyre ligjëratave në shkolla. Institucionet arsimore nuk janë dhe nuk duhet të shndërrohen në hapësira propagandistike për struktura që synojnë të rishkruajnë historinë e Kosovës dhe të kriminalizojnë rezistencën për liri.

Gjykata Speciale nuk është instrument i drejtësisë universale, por një gjykatë selektive dhe politike, e cila gjykon vetëm një palë – UÇK-në – duke injoruar krimet gjenocidale të shtetit serb në Kosovë. Përpjekja për ta paraqitur këtë gjykatë si

autoritet edukativ për nxënësit përbën ndërhyrje të drejtpërdrejtë në ndërgjegjen historike të brezave të rinj.

Nëse Drejtoria e Arsimit në Prishtinë dhe MASHTI pretendojnë se po veprojnë në frymën e edukimit demokratik dhe pluralist, atëherë janë të obliguara që të organizojnë ligjëratat shtesë jashtë kurrikulës, ku nxënësit të informohen:


- për karakterin çlirimtar të UÇK-së,
- për tentativat e vazhdueshme për komprometimin e saj,
- për padrejtësitë, selektivitetin dhe natyrën politike të Gjykatës

Speciale,

- dhe për përpjekjet e hapura për rishkrimin e historisë së Kosovës.

Çdo qasje njëanshme që favorizon narrativen e Gjykatës Speciale, pa debat, pa balancë dhe pa të vërtetën historike, përbën akt të dëmshëm për interesin kombëtar dhe shtetëror të Kosovës.

Kosova nuk ka nevojë për edukim që prodhon vetëfajësim kolektiv dhe delegjitimon luftën çlirimtare, por për arsim që mbron të vërtetën historike, dinjitetin kombëtar dhe sovranitetin e saj.



Fenerbahçe synon ta "rrëmbejë" Asllanin para rivalëve evropianë

FENERBAHÇE, 23 JANAR - Fenerbahçe po punon intensivisht për t'i siguruar shërbimet e sulmuesit të Kosovës, Fisnik Asllani, i cili pritet të largohet në fund të sezonit. Klubi turk e ka identifikuar 23-vjeçarin si zgjidhje e

përkryer për ta forcuar repartin ofensiv, falë forcës fizike, aftësisë në luftën ajrore dhe instinktit për gol. Asllani aktualisht luan te TSG Hoffenheim në Bundesligën gjermane dhe ka shënuar 6 gola në 17 ndeshjet e këtij sezoni. Përveç kualiteteve

fizike, ai ka përvojë ndërkombëtare, duke përfaqësuar Kosovën dhe duke shënuar golin e fitores ndaj Suedisë në kualifikimet për Botërorin 2026. Por, Fenerbahçe nuk është i vetmi që e kërkon sulmuesin dardan. Pas tij janë edhe top

skuadrat si Bayern Munchen, Barcelona e Borussia Dortmund. Interesimi i madh tregon se turqit duhet të veprojnë shpejt për të përparuar në negociata dhe për të mbyllur një marrëveshje që mund ta ndryshojë sezonin e tyre.



FFK-ja REAGON NDAJ LAJMEVE PËR DËNIM NGA UEFA: GËNJESHTRA NË PRAG TË ZGJEDHJEVE

PRISHTINË, 23 JANAR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka reaguar rreth lajmit se FFK-ja ka marrë dënim nga UEFA për keqpërdorim të fondeve. FFK-ja mohon këto raportime duke i cilësuar gënjeshtër në prag të procesit zgjedhor të kreut të federatës. FFK-ja ka thënë se marrëveshja me UEFA-n nuk është aktuale, por është nënshkruar në vitin 2023 dhe parasheh që FFK-ja ta forcojë departamentin e vet të licensimit dhe, mbi të gjitha, të ushtrojë kontroll më

rigoroze ndaj klubeve anëtare të saj në disa segmente. "Fjalët e dala në media se UEFA e ka dënuar FFK-në për keqpërdorim të fondeve të saj, përkatësisht të ndërlidhura me procesin e licensimit të klubeve, nuk janë asgjë tjetër përveç se gënjeshtër të pastra që kanë për qëllim të deformojnë realitetin pikërisht në prag të procesit zgjedhor në të cilin gjendet FFK-ja. Marrëveshja në fjalë e nënshkruar ndërmjet FFK-së dhe UEFA-s, nuk është aktuale, por është nënshkruar



në vitin 2023 dhe parasheh që FFK-ja të forcojë departamentin e vet të licensimit dhe mbi të gjitha të ushtrojë kontroll më rigoroze ndaj klubeve anëtare të saj në disa segmente. UEFA ndanë

fonde vjetore për të mbështetur Federatat Kombëtare në procesin e licensimit dhe për shkak të gjetjeve që janë pjesë e kësaj marrëveshjeje, i ka ndaluar FFK-së, shumë prej 50 mijë

eurosh. Sido që të jetë, është e çuditshme sesi persona të caktuar, keqpërdorin dokumentet në të cilat dikur kishin qasje dhe tentojnë që nëpërmjet keq-interpretimeve të krijojnë amulli në opinion, duke nënçmuar edhe nivelin e inteligjencës së adhuruesve të futbollit, të cilët këta persona të pandërgjegjshëm i vënë në lajthitje", është thënë në reagimin e FFK-së. Përndryshe, marrëveshje të tilla UEFA nënshkruan shumë shpesh me shumë federata kombëtare.

NESËR ZHVILLOHET SUPERKUPA E KOSOVËS



ANTALI, 23 JANAR - Kampionia e Kosovës në futboll, Drita dhe fituesja e Kupës së Kosovës, Prishtina, nesër (e diel) ndeshen në kuadër të Superkupës së Kosovës. Kjo ndeshje do të luhet në Antalya të Turqisë. Sikurse është bërë "modë" vitet e fundit, skuadrat e Kosovës po zhvillojnë

ndeshjen e finales së Superkupës në bregdetin e ngrohtë turk në janar. Për shkak se të dyja skuadrat finaliste janë duke i zhvilluar përgatitjet në Antali, ndeshja e Superkupës së Kosovës do të zhvillohet në stadiumin e hotelit "Mardan Palace", me fillim nga ora 12:30 sipas kohës lokale në Kosovë.

Në stinorin e kaluar Superkupa i kishte takuar Ballkanit pa luajtur ndeshje, pasi suharekasit kishin fituar edhe titullin edhe Kupën në Kosovë. Drita, Superkupën e fundit e ka fituar në vitin 2018, kurse Prishtina më 2023. Vendimi që Superkupa e Kosovës mes Dritës dhe Prishtinës të zhvillohet në Turqi si zakonisht

ka ngjallur reagime në opinionin sportiv, sidomos te tifozët që e kanë të pamundur udhëtimin për arsye financiare. Kjo ka hapur dilema nëse Federata e Futbollit e Kosovës, apo vetë klubet kanë bërë zgjedhjen e duhur, pasi një garë e rëndësishme e futbollit të Kosovës, po largohet nga publiku.

FUNDI I NJË EPOKE? CRISTIANO RONALDO DREJT PENSIONIMIT



RIAD, 23 JANAR - Ylli i futbollit Cristiano Ronaldo po e konsideron seriozisht pensionimin nga futbollit vitin e ardhshëm. Pesë herë fituesi i Topit të Artë që ka fituar thuajse të gjitha trofetë në futboll është duke konsideruar të ardhmen, ndërsa një nga opsionet më të mundshme është largimi nga Al Nassr si

dhe t'i "varë këpucët". Sipas asaj që raporton gazetari i njohur Ben Jacobs, Ronaldo pritet të largohet nga Al Nassr në verën e vitit 2027 dhe po konsideron seriozisht pensionimin nga futbollit. Në bazë të raportimit, Ronaldo tashmë ka vendosur ta ndërpresë bashkëpunimin me klubin arab, me këta të fundit

që po shpresojnë ta mbajnë duke i ofruar përqindje në aksionet e skuadrës. Arabia Saudite po shpreson ta mbajë Ronaldon si ambasador si dhe t'i japë plot 15 për qind të aksioneve të Al Nassr, aty ku do të bëhet drejtuesi i klubit, një objektiv që portugezi e ka shprehur publikisht disa herë. Kujtojmë, Ronaldo aktualisht

është i fokusuar për ta fituar titullin në Arabinë Saudite, si dhe Kupën e Botës me kombëtaren e Portugalisë, trofeu i vetëm që ende nuk e ka shijuar. Përpos tyre, ish-ylli i Real Madridit ka bërë të qartë se ka për objektiv të bëhet golashënuesi i parë që shkon në shifrën e 1 000 golave.

Harry Kane, sulmuesi më efikas në Evropë

BAYERN, 23 JANAR - Ylli i Bayernit, Harry Kane, ka shënuar 34 gola në 29 ndeshje në të gjitha garat këtë sezon, përfshirë 21 në Bundesligë. Kjo është një normë e jashtëzakonshme

shënimi, duke nënvizuar statusin e Kanes si një nga sulmuesit më të mirë në botë. Statistikat gjithashtu paraqesin një gjë të qartë: sipas Squawka, Kane është sulmuesi më efikas në

Evropë. Ai ka normën më të lartë të konvertimit të gjuajtjeve midis të gjithë lojtarëve që kanë shënuar 10 ose më shumë gola në ligë këtë sezon në pesë ligat kryesore të Evropës.

30.88 për qind e gjuajtjeve të tij përfundojnë në rrjetë. Me fjalë të tjera, pothuajse çdo e treta e gjuajtjes nga Kane rezulton në një gol, nivel absolut elitar.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Alba Beton” Sh.p.k., Krushë e Vogël, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror - rërës - rërës kuarcore dhe zhavorrit, në Z.K. Krushë e Vogël, Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.03.2026 në ora 11:00 në ambijentet e ne SHMU “Krusha e Vogël”, rruga 113 Martirët, Krushë e Vogël, Komuna Prizren, do të organizohet debat publik nga Kompania “Alba Beton” Sh.p.k., Krushë e Vogël, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/5289487423?pwd=atEPUrNDxCwMcX5GSCHJ57NmAu7JDN.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Alba Beton” Sh.p.k., Krushë e Vogël, Prizren, për Pëlqim Mjedisor, për thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror - rërës - rërës kuarcore dhe zhavorrit, në Z.K. Krushë e Vogël, Prizren.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Instituti për Film dhe Teatër” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811930389 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Instituti për Film dhe Teatër” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811930389 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Instituti për Film dhe Teatër” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 811930389 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Florenti Qeramik” L.L.C. me seli në Glllogoc, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812009000 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Florenti Qeramik” D.O.O. od Glllogoc, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812009000 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Florenti Qeramik” L.L.C. with headquarters Glllogoc, has come to the decision to quit its business: 812009000 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fitim Gërbeshi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “Shtjefën Gjeçovi” Prishtinë.

- Ferdonije Shllaku shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

-Mark Palushi shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Flutur Naka shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Luan Alijaj shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Agim Leka shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Berat Kasapi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Pjeter Bogdani” Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Krenar Abrashi” B.I. me nr. Unik: 811133719.
- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.


- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

“Palma” SH.P.K.
me numër Unik
Identifikues:
810679417, Gjilan
me pronar Ekrem
Shahini bënë shpallje
në gazetë për
zvogëlim të kapitalit
nga 1759953.92 Euro
në 4000 Euro.



Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjeipuneshpejte



RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fitim Gërbeshi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “Shtjefën Gjeçovi” Prishtinë.
- Ferdonije Shllaku shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Luan Alijaj shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Agim Leka shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Berat Kasapi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Pjeter Bogdani” Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.
- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Krenar Abrashi” B.I. me nr. Unik: 811133719.
- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L